[Shqiptarja.com]

E shtunë 8 Korrik 2023 - Përditësimi i fundit 10:50

Kërko

LIVE Shqiptarja.tv

HOME EDICIONET LOKALE KRONIKË POLITIKË SHËNDETI EKONOMI SPORT KOSOVË & RAJONI BOTË KULTURË EDITORIAL OPINION

TË FUNDIT SOCIALE DREJT PUNËS SPECIALE LIFESTYLE VIP & SPEKTAKËL RECETA HOROSKOPI DOSJE FOTOGALERI VIDEOGALERI PIKË E ZEZË SONDAZHE

Flash Krujë, asgjësohen 883 rrënjë kanabisi Mafsheq, Nuaj, Bruzë Mal, Krastë e Shkozë Bardh

BRAJAT DHUNOJNË PËR GURORËN

POP 5 Lajmet me të lexuarat të 5 minutave të fundit

1 Ndryshime i formatit të Qendrës Shëndetësore "Dom Nikollë Lacaj" e preferuar: Ndërhyjnë dy lidhje me Ke'Albania', ka kthehen vit derdi

2 Ne krah të regjiurit Korrcë, Duk t,ka rënë shi! Sot ka pasënuar në ndodhi grak

3 di vjo

3 'Vrisha si të ki ka bje se po gjuan me fëmiqt', Mbrëmë Vlorë ka ndodhur gjëmara, kërcënimet e njerëzve ndër fqinjë

4 E egzaktësi me një shifër, ndryshon i viti ku Nikolla i Parë bëri i Njësuar Sperans, kërcënimet Ende nuk kam marrë një fjalë publike nga Vujiari

5 Klubi i Serie A 'Ret shqip', vërtitë edhe Thomas Strakosha

Kronikë

Dhuna barbare për guroren/ Pas denoncimit të Shqiptarja.com e Report Tv shpallet në kërkim Rexhep Rraja, djali i deputetit socialist! Në kërkim dhe 2 vëllezërit e Rrahman Rrajës

Pak orë pas denoncimit në Report TV dhe Shqiptarja.com policia shpalli në kërkim Rexhep Rrajën, djalin e deputetit socialist të Krujës Ramazan Rraja. Në kërkim dhe dy vëllezërit e tij dhë një anëtar i fisit Rraja. Ndërsa 4 persona janë në pranga për dhunën barbare që pjesëtarë të fisit Raja ushtruan ndaj kushërinjve Maja pasi u ankuan se guroja në pronësi të tyre po u dëmtonte banesat.

- SONDAZHI/ A duhet të japë dorëheqjen deputeti Raja?
- Denoncimi: Pse policia s'përmendi Rrajën gjëkundi
- Ja FOTOT/ Djali i deputetit Raja godet me shkop gome Bilbil Majën, ndërsa vëllai i ligjvënësit i drejton armën
- VIDEO/ 'Vrite, vrite!' U ankuan për guroren në Krujë, fisi i deputetit Rrahman Raja dhunon barbarisht me shkopinj bejsbolli dy kushërinjtë Maja! Në kërkim djali dhe dy vëllezërit e tij



Rexhep Rraja duke rrahur Bilbil Majën

Redaksia
7 Korrik, 21:15 | **Përditësimi: 7 Korrik, 23:36**

Ndonëse Rexhep Rraja, djali i deputetit socialist Ramazan Raja, ishte pjesë e grupit të dhunuesve të cilët rrahin barbarisht me shkopinj gome dhe druri dy kushërinjtë Maja, emri i tij nuk figuronte as në njoftimin e djeshëm të policisë dhe as në njoftimin e mesditës së sotme.

Vetëm pak orë më pas, pasi Report TV dhe Shqiptarja.com evidentuan këtë fakt - **Lexo ketu: Video e dhunës barbare/ Djali i deputetit Raja godet me shkop gome Bilbil Majën edhe pse kishte humbur ndjenjat, pse policia s'e përmend asgjëkundi?**

LEXO EDHE:
Shteti duhet të japë një shembull të fortë, si me rastin e Kokëdhimës

Policia ndërhyri me një njoftim të tretë për median ku tashmë lajmëron se kishte identifikuar dhe shpallur në kërkim dhe Rexhep Rrajën.

Në videon e dhunës barbare filmuar nga vetë pjesëtarët e grupit Raja, Rexhep Rraja dallohet me shkop bejsbolli në dorë teksa qëllon brutalisht Bilbil Majën. Madje dhuna vazhdon edhe kur ky bie në tokë duke ndjenja dhe i mbuluar me gjak në verandë, në përpjekje për ta larguar. Ngjarja u regjistrua mesditën e 6 korrikut 2023 në një lokal në aksin Fushe - Krujë Thumanë.

> *Në vazhdim të veprimeve hetimore në lidhje me ngjarjen e ndodhur me datë 06.07.2023, ku në një lokal në aksin rrugor Fushë Krujë-Thumanë, një grup personash kanë goditur me sende të forta shtetasit Bujar dhe Jashar Maja, Policia e Shtetit ka ndaluar 4 persona dhe ka shpallur në kërkim 3 të tjerë.*
>
> *Në vijim të veprimeve hetimore është identifikuar dhe shtetasi Rexhep Rraja, për të cilin janë dërguar materialet pranë Prokurorisë së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Shtetasi është shpallur në kërkim policor dhe vijon puna nga shërbimet e Policisë, për lokalizimin dhe kapjen e tij. Vazhdon puna për identifikimin e personave të tjerë të përfshirë në këtë ngjarje", njoftoi Policia rreth orës 21: 14 minuta të mbrëmjes së sotme 7 korrik.*

Deri tani për **dhunën brutale që anëtarë të fisit Raja ushtruan drejt dy kushërinjve**, Bilbil dhe Jashar Maja janë arrestuar 4 persona, ndërsa 4 janë shpallur në kërkim mes tyre dhe dy vëllezërit e deputetit socialist të Krujës, Flamur dhe Xhelal Raja.

Shkak është bërë një gurore në fshatin Borizanë, në pronësi të Përparim Rrajës, kushëriri i deputetit, i cili ka leje shfrytëzimi dhe licencë për këtë aktivitet. Kushërinjtë Bilbil e Jashar Maja ishin ankuar se shpërthimet gjatë punimeve në gurore, po u shkatërronin banesat e tyre por dhe të zonës përreth, 200 metra në vijë ajrore nga guroja.

Mesditën e së enjtes ata ishin në lokal me inxhinierin e gurores për ti kërkuar që shpërthimet të ishin më të kontrollusara pasi po u dëmtoheshin banesat, kur grupi i dhunuesve mësyu lokalin dhe ata bëhen prehë e një dhune barbare.

Vidoja është filmuar nga vetë pjesëtarët e fisit Rraja. Duke e ndier veten të paprekshëm Rrajat donin t'ia bënin të qartë të pambrojturve se q'farë u ndodh nëse ankohen për guroren në Borizanë në pronësi të Përparim Rrajës, kushëriritë të deputetit socialist Rrahman Raja.

Policia shoqëroi dhe Përparim Rrajën por më pas u la i lirë.

Të arrestuar	
1.	Ineid Raja 23 vjeç,
2.	Eni Kullaj, 27 vjeç,
3.	Kujtim Përdaku, 57 vjeç
4.	Andi Raja 28 vjeç

Në kërkim janë shpallur shtetasit	
1.	Xhelal Raja, 65 vjeç,
2.	Flamur Raja, 55 vjeç,
3.	Rexhep Raja
4.	K. Rr., 31 vjeç.

Rexhep Rraja, djali i deputetit duke goditur me shkop Bilbil Majën! Me rreth të kuq vëllai i deputetit

SI E./S.G/Shqiptarja.com

TAG: gurore borizanë krujë Dumesi rexhep rraja mahaman rrahja Brajat dhunojnë per guroren

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Pas dhunës për guroren a duhet të japë dorëheqjen deputeti Rrahman Rraja?

Po | Jo | Nuk e di

Lajme të tjera

Fisi Rraja dhunë në Krujë/ Çuçi: E papranueshme, askush nuk është mbi ligjin, autorët s'do t'i shpëtojnë përgjegjësive
7 Korrik, 20:17


Si thatë ju, përse ikin shqiptarët nga Shqipëria?
Mentor Kikia
7 Korrik, 20:11

Transmetimi i pamjeve të dhunës në Fushë Krujë, AMA: Kujdes, nxisin dhunë
7 Korrik, 19:38

Rrajat dhunojnë 2 kushërintë, Tabaku: Familjarët e deputetit sundojnë si qeveri paralele! Meta: Mban emrin dhe fytyrën e Edi Ramës
7 Korrik, 19:25

Ja FOTOT/ Djali i deputetit Raja godet me shkop gome Bilbil Majën, ndërsa vëllai i ligjvënësit i drejton armën
7 Korrik, 18:51

Gurorja e Rrajave po u dëmton banesat por askush nuk i dëgjon, Banorët e Borizanës tregojnë dëmet: Mbrëmë ishte shpërthimi i fundit! Thamë se u hap toka
7 Korrik, 18:37

Krujë/ Rrajat 'e paprekshëm' filmuan dhunën brutale ndaj kushërinjve Maja për të frikësuar të jetërit që të mos ankoheshin për guroren e Borizanës
7 Korrik, 17:01

Video e dhunës barbare/ Djali i deputetit Raja godet me shkop gome Bilbil Majën edhe pse kishte humbur ndjenjat, pse policia s'e përmend asgjëkundi?
7 Korrik, 16:54

Fisi i deputetit Raja dhunon barbarisht dy kushërinjtë Maja, gazetarja: Shteti është në anë të banditëve
Lindita Çela
7 Korrik, 16:36

U dhunua barbarisht nga fisi Rraja, Jashar Maja për Report Tv: Policia ka frikë nga ata, erdhi pas dy orësh! Na rrahën, s'ua fal sa ti bie dielli tokës
7 Korrik, 15:48

VIDEO/ 'Vrite, vrite!' U ankuan për guroren në Krujë, fisi i deputetit Rrahman Raja dhunon barbarisht me shkopinj bejsbolli dy kushërinjtë Maja! Në kërkim djali dhe dy vëllezërit e tij
7 Korrik, 11:16

Zyrtare/ Tre afrime me eksperiencë, Diego Longo formon Teutën
7 Korrik, 11:01

HOROSKOPI

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Qëndroni!

© 2011 - 2023 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje